



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0509

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani - Kryetare, duke vendosur mbi ankesën e grupit të operatorëve ekonomik “As Tech” Sh.P.K. & “Shkëlqimi Invest” Sh.P.K. kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 04.07.2023 të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Rahovecit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rregullimi dhe Mirëmbajtja e Hapësirave të Jashtme dhe të Brendshme në Institucionet Publike” me numër të prokurimit 623-23-2282-2-1-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 14.09.2023 me prezencën e palëve, me datë 19.09.2023 merr këtë:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik “As Tech” SH.P.K. & “Shkëlqimi Invest” SH.P.K. kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 04.07.2023 të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Rahovecit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rregullimi dhe Mirëmbajtja e Hapësirave të Jashtme dhe të Brendshme në Institucionet Publike” me numër të prokurimit 623-23-2282-2-1-1.
2. Anullohet Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i datës 04.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
3. Detyrohet Autoriteti Kontraktues - Komuna e Rahovecit për zbatimin e këtij vendimi si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmerri masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP.
4. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtrij kërkesë për kthimin e tarifës së ankesës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrihet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datë 21.03.2023, Komuna e Rahovecit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rregullimi dhe Mirëmbajtja e Hapësirave të Jashtme dhe të Brendshme në Institucionet Publike” me numër të prokurimit 623-23-2282-2-1-1 dhe numër të brendshëm 623-23-028-2-1-1. Kjo procedurë ishte e ndarë në 4 Lote (ndarje/pjesë).

Me 04.07.2023, Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit për Llot 4 ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik “Grupin e Operatoreve Ekonomik Milazim Bala B.L Bajram Ha. Gashi B.L”.

Me 10.07.2023, Ankuesi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 11.07.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Duke qenë i pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues, operatori ekonomik ankues me datë 21.07.2023 ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 2023/0509.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim:

- **Pretendimi i parë (I)** - *“Ne vendim ceket se ne oferte ne kemi dorëzuar listën si dhe vendimin për menaxherin e projektit dhe udhëheqësin e punishtes por nuk kemi dorëzuar dëshminë si CV, Diplomën dhe kontratën. Konsiderojme se Oferat jone dhe tenderi nuk është vlerësuar si duhet përderisa AK nder tjerash nuk e ka respektuar nenin 10 te Udhëzuesi nr 001/2023 i prokurimit publik: Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve. LPP thotë qe AK mund te kërkojë sqarime për dokumentet ekzistenciale para hapjes. Ne oferte ne kemi dorëzuar Listën e punëtoreve dhe Vendimet për menaxher te projektit dhe udhëheqës se punishtes por për shkak te vëllimit te dokumentacionit për shkak te kapacitetit te kufizuar te ngarkimit te dokumenteve ne sistem dh e kohës se shkurtër nuk i kemi ngarkuar dokumentet tjera, ekzistenca e te cilave ka datuar edhe atë dite por qe kemi qene te vetëdijshëm se AK pastaj mund te kërkojë sqarime, siç bëjnë te gjitha AK tjera”.*

- **Pretendimi i dytë (II)** - *“OE me i shtrenjte i rekomanduar për loto 4 Konzorciumi Milazim bala dhe Bajram përgjegjshme sepse fillimisht OE Bajram Gashi nuk e ka plotësuar si duhet deklaratën nen betim, OE e ka plotësuar Deklaratën me datën 02.05.2023 ndërsa hapja e ofertave ka qene me datën 23.05.2023. Një oferte nuk është e përgjegjshme kur nuk plotësohet si duhet deklarata nen betim e cila është kusht administrativ. OE e ka nënshkruar deklaratën nen betim ne kohen kur procedura ende ka pasur korrigjime dhe pas nënshkrimit te deklaratës nen betim AK përsëri ka dërguar Njoftim për korigjim. Kjo e bënë te pavlefshëm ofertën sepse OE ka dhënë deklarate nen betim për ofertën e tij ndërsa pas këtij nënshkrimit AK ka bere ndryshime dhe OE nuk ka dhënë nënshkrim-zotim se është i përgjegjshëm pas këtyre korigjimeve”.*

- **Pretendimi i tretë (III)** - *“Ne oferte te tyre kane dhënë çmime jo normalisht te larta ne disa pozicione qe ata kane beso jme qe kane pasur informacion se mund te shfrytëzohen me shume. Nëse i krahasojmë çmimet e disa pozicioneve kyqe te ofertës se tyre me ofertën tone ka dallime jashtëzakonisht te mëdha-substanciale. AK dëmtohet shume duke e përzgjedh një oferte te tillë të manipuluar, kur vetëm për servisim te klimes për një njësi zgjedh çmimin 350 euro, kjo përveç qe është manipulim i madh i ofertës, nuk mund te gjendet as ne treg një çmim i tille, është 430% me e larte se çmimi i tregut ose i ofertës tone. Pastaj çmimi i furnizimit me klima 12000BTU është jashtëzakonisht i larte, siç ndërsa manipulim i theksuar vërehet ne pozicionin 47-
Furnizimi si dhe montimi i Klimes 24000 BTU ku gr. i OE kane dhen çmim 3100 për një klime qe ne treg për brendin qe kane ofru mund te sillet pre 850-950 euro por jo 3100 me një rritje 400% me shumë se çmimi i tregut”.*

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7 dhe 59 të LPP si dhe nenin 10 të UPP. Operatori ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të miratohet ankesa ashtu që të kthehet lënda në Rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues në OSHP me datë 25.07.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues.

Me datë 07.08.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: *“ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet vendimi i AK për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”*.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Pala ankuese ka dërguar te Paneli Shqyrtues njoftimin sipas të cilit pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues ndërsa Autoriteti Kontraktues ka dërguar njoftimin sipas të cilit nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, deklaratimet e palëve dhe ekspertit në shqyrtimin kryesor, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor: *“Autoriteti Kontraktues - Komuna e Rahovecit ka vepruar në kundërshtim me nenin 72 të LPP dhe me nenin 38.1 të të RRPP si dhe me nenin 10 të UPP. Duke e ditur se GOE ankues në këtë rast ka një çmim shumë më të lirë se GOE i rekomanduar, AK do të duhej t'i shtjerrte mundësitë para se ta eliminonte GOE ankues. Në këtë formë duke e ditur që GOE e ka paraqitur listën e vulosur dhe të nënshkruar lidhur me angazhimin e stafit, AK do të duhej t'i kërkonte të gjitha të dhënat tjera lidhur me plotësimin apo sqarimin e dokumentacionit të mangët. Në këtë formë pretendimi i GOE është i bazuar”*.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor: *“Bazuar në trajtimin e dokumentacionit (ofertës së plotë të GOE të rekomanduar) - Deklarata nën betim është plotësuar ashtu siç duhet. As legjislacioni primar e as sekondar nuk e precizon se kur duhet të nënshkruhet Deklarata nën Betim. E njëjta është nënshkruar në afatin sa tenderi ishte i hapur dhe është irelevante (e parëndësishme) si fakt nëse një deklaratë është nënshkruar para hapjes së ofertave”.*

Lidhur me pretendimin e tretë (III) ankimor: *“Duke u bazuar në dokumentimin se oferta e GOE të rekomanduar (1613.60 euro) ka vlerë financiare të peshimit të çmimit mbi 100% më e shtrenjtë se oferta e GOE ankues (765.48 euro), si ekspert shqyrtues paraqes se AK nuk ka respektuar nenin 1 dhe nenin 6 të LPP. Po ashtu AK nuk i ka dhënë përgjigje konkrete GOE ankues në fazën e kërkesës për rishqyrtim mirëpo vetëm ka konkluduar se i njëjti nuk i plotëson kushtet që të trajtohet si abnormalisht i ulët apo i lartë. Bazuar në atë se ka një shpërputhje të madhe në mes të çmimeve të ofertuara, si ekspert shqyrtues paraqes se AK në fazën e rivlerësimit duhet të trajtoj aspektin e çmimeve njësi dhe përderisa ekziston neni 41.6 i RRPP... AK ose duhet të diskualifikoi GOE të rekomanduar i cili ka ofruar çmime të larta ose në këtë formë dëmtohet edhe buxheti i komunës”.*

Me datë 14.09.2023 është mbajtur seanca e shqyrtimit kryesor ku prezent kanë qenë përfaqësuesit e palëve procedurale si dhe eksperti shqyrtues.

Përfaqësuesi i palësankuese gjatë shqyrtimit kryesor është deklaruar se qëndron prapa pretendimeve ankimore duke shtuar se pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues si dhe pajtohet me të gjeturat e ekspertit sipas të cilave pretendimi i parë dhe pretendimi i tretë janë të bazuara mirëpo nuk pajtohet me të gjeturat e ekspertit sipas të cilave pretendimi i dytë është pretendim i pabazuar.

Përfaqësuesi i autoritetit kontraktues gjatë shqyrtimit kryesor është deklaruar se qëndron prapa njoftimit mbi vendimin të datës 07.04.2023 dhe ka shtuar se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues. Po ashtu ka kërkuar të refuzohet si e pabazuar ankesa palës ankuese.

Eksperti shqyrtues gjatë shqyrtimit kryesor është deklaruar se qëndron prapa të gjeturave dhe rekomandimeve të evidentuara në raportin e ekspertit shqyrtues. Po ashtu ka konfirmuar se ankesa e palës ankuese duhet të miratohet si pjesërisht e bazuar ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim, ngase me një kërkim të thjeshtë në internet mund të vërehen se çmimet e rekomanduara për kontratë nuk korospodojnë me çmime të tregut.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 59 dhe 61,72 të LPP, pastaj me nenin 38 paragrafin 38.1 dhe nenin 41 paragrafin 41.4 dhe 6 të RRPP si dhe nenin 10 të UPP.

Pas analizimit të gjendjes faktike të përmbledhur si më sipër, Paneli Shqyrtues ka gjetur se eksperti shqyrtues ka trajtuar pretendimet e palës duke vlerësuar se pretendimi i parë dhe pretendimi i tretë janë pretendime të bazuara ndërsa pretendimi i dytë është pretendim i pabazuar. Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh deklaratimet e palëve lidhur me rekomandimet e ekspertit si dhe deklaratimet e palëve në seancën e shqyrtimit kryesor. Megjithatë argumentimi i ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin e parë se i referohen nenit 72 të LPP lidhur me nenin 38 paragrafin 38.1 të RRPP si dhe nenin 10 të UPP. Përmes nenit 72 të LPP përcaktohet se *“Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji”*. Ndërsa përmes nenit 38 paragrafit 38.1 të RRPP përcaktohet se *“Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK “Kërkesë për sqarim të tenderit”. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike”*.

Paneli sqaron se lidhur me ofertë e OE ankues gjatë rivlersimit udhëzohet të veproj në harmoni me nenin 72 të LPP përcaktohet se *“Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji”*. Ndërsa përmes nenit 38 paragrafit 38.1 të RRPP përcaktohet se *“Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK “Kërkesë për sqarim të tenderit”. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike”*.

Tutje konstatimet e ekspertit lidhur me pretendimin e dytë i referohen dosjes së tenderit por edhe LPP dhe akteve sekondare në fuqi për prokurimin publik. Po ashtu konstatimet e ekspertit lidhur me pretendimin e tretë

i referohen nenit 1 dhe 6 të LPP lidhur me nenin 41 paragrafin 41.6 të RRPP.

Përmes nenit 1 të LPP përcaktohet se “Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese...”. Përmes nenit 6 të LPP përcaktohet se “Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit”. Njëkohësisht përmes nenit 41.6 të RRPP përcaktohet se “Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ulët sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP - Shkresa standarde për tenderët jonormalisht të ulët”.

Duke marrë parasysh gjendjen faktike të elaboruar më sipër si dhe bazën ligjore me të cilën përfshihet kjo gjendje faktike, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet e palës ankuese. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parë dhe i tretë i palës ankuese janë të bazuara ndërsa pretendimi i dytë është pretendim i pabazuar.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Rahovecit të datës 04.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rregullimi dhe Mirëmbajtja e Hapësirave të Jashtme dhe të Brendshme në Institucionet Publike” me numër të prokurimit 623-23-2282-2-1-1, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Tutje konstatimet e ekspertit lidhur me pretendimin e dytë i referohen dosjes së tenderit por edhe LPP dhe akteve sekondare në fuqi për prokurimin publik. Po ashtu konstatimet e ekspertit lidhur me pretendimin e tretë i referohen nenit 1 dhe 6 të LPP lidhur me nenin 41 paragrafin 41.6 të RRPP. Përmes nenit 1 të LPP përcaktohet se “Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese...”. Përmes nenit 6 të LPP përcaktohet se “Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit”.

Lidhur me Ofertën e të rekomanduarit, ankuesi ka pohuar edhe gjatë seancës dëgjimore dhe është konfirmuar nga eksperti shqyrtues, se i njëjti në disa pozicione, ka ofertuar në çmime të larta në krahasim me çmimet e tregut, paneli pas administrimit të provave vëren tek NËNTOTALI B Pozicioni 39, "Servisimi dhe mbushja e klimave" është paraparë çmimi njësi e për të cilin OE i rekomanduar, kishte ofertuar në vlerë prej është 350.00€ AK lidhur me këtë pozicion edhe pse fare nuk e ka specifikuar se për çfarë lloje të klimës bëhet fjalë në paramasë e cila do të servisohet, Lidhur me këtë, AK gjatë seancës ka pohuar që "përveç servisimit /mbushjes së klimave do të ndërrohen edhe mbajtësit e hekurit për klima". Paneli sqaron se një pohim i tillë nuk figuron në

paramasë dhe rrjedhimisht si till ka vetëm karakter "deklarativ" i cili nuk parashihet tek "Servisimi dhe mbushja e klimave". Andaj meqenëse ky pretendim është ngritur si shqetësim nga ana e OE dhe po ashtu është konfirmuar nga Eksperti Shqyrtues, shtuar kësaj edhe pozicionin Pozicioni 47 "Furnizimi dhe montimi i klimës 24000 BTU" për të cilin OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmim 3100.00€ kurse ankuesi kishte ofruar dëshmi disa profatura të cilat përmbanin çmime rreth 400% më shtrenjta, Paneli shqyrtues sqaron se AK, bazuar në nenin 61 të LPP lidhur me nenin 41.4 të Rregullores për Prokurim Publik cituar: *"Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore", autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së*". Njëkohësisht përmes nenit 41.6 të RRPP përcaktohet se *"Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ulët sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP - Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët*". Për më tepër Paneli sqaron se ankuesi kishte ofruar në ankesën e tij si dëshmi profatura lidhur me produktet kontestuese "Klima UBT" të cilat sipas këtij paneli bazuar edhe në raportin e ekspertizës, nga profaturat e ofruara nga Ankuesi lidhur me produktin e njëjtë vërehet se çmimet e ofruara në ofertën e të rekomanduarit përmbajnë çmime shumë të larta, megjithatë Obligohet AK që gjatë rivlerësimit të bëjë hulumtim të tregut për të gjitha produktet e kontestuar me ankesën (Nr. Protokolli 509/2023) e të cilat sipas bindjes së këtij paneli nuk janë trajtuar me kujdesin e duhur profesional nga ana e AK. Andaj paneli vlerëson AK që në përputhje me nenin 1 dhe 6 dhe 61 LPP lidhur me nenin 41.4 të RRPP dhe nenin 10 UPP të kërkon sqarim nga OE i rekomanduar, duke i krahasuar çmimet e ofruara me çmimet reale të tregut, kurse lidhur me Ofertën e OE ankuesi obligohet AK të veprojë në harmoni me nenin 72 të LPP lidhur me nenin 38 të RRPP.

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim të kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së dhe jo të shohë ligji në mënyrë selektive, andaj bazuar në pretendimet ankimore dhe atë që u përshkrua si më lartë, paneli vendosi që kjo procedurë e prokurimit të kthehet në ri-vlerësim me qëllim që të vlerësohen në mënyrë të drejtë kërkesat e FDT dhe njoftimit për kontratë kundrejt dëshmitë të ofruara në ofertat e OE pjesëmarrës në këtë aktivitet, duke vepruar në harmoni me nenin 1, 7, 59, 60, 61, 69 dhe 72 të LPP lidhur me nenin 38 dhe 41.4 të RRPP.

Paneli shqyrtues sqaron se gjatë rivlerësimit Autoriteti Kontraktues duhet të ketë parasysh edhe nenin 59 paragrafi 4 të LPP lidhur me nenin 45.2.1 të RRPP se edhe nëse do të kishte lëshime të vogla eventuale, që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat tjera të parashtruara me njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, për panelin shqyrtues do të konsideroheshin jo të rëndësishme në raport me interesin publik dhe fondet publike, e për të cilat fonde dhe burime publike, autoritet kontraktues janë të obliguara të përdorin në mënyrë ekonomike. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së pasi që dihet që qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë mënyrën më efektive transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve

kontraktuese ne Republikën e Kosovës.

Përfundim

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin shqyrtues dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimet ankimore të OE ankues detyrojnë Paneli që aktiviteti i prokurimit në këtë rast t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit për ti përmbushur qëllimet parësore të LPP, sikurse sanksionohen ato me nenin 1, të Ligjit të cituar.

Prandaj duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Rahovecit të datës 04.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rregullimi dhe Mirëmbajtja e Hapësirave të Jashtme dhe të Brendshme në Institucionet Publike” me numër të prokurimit 623-23-2282-2-1-1, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicoj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - " AS Tech " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: